

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6906
E shtunë, 27 maj 2023
Çmimi 0.40 €

Grenelli: Thaçi duhet të lirohet, evropianët po bëjnë një punë të pistë

IFAQE3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

QYTETARËT SERBË I PENGUAN KRYETARËT E RINJ TË TRI KOMUNAVE NË VERI, ZVEÇAN, LEPOSAVIQ DHE ZUBIN POTOK, TË HYJNË NË ZYRA IFAQE 4

SITUATË E TENSIONUAR NË VERI, SHBA-ja KËRKON TË NDËRPRITËT DHUNA



Grupe qytetarësh serbë janë përplasur të premtën me Policinë e Kosovës e cila po i ndihmonte kryetarët e rinj të tri komunave të banuara me shumicë serbe në verium e vendit, Zvečan, Leposaviq dhe Zubin Potok, për të hyrë në zyrat e tyre. Policia e Kosovës përdori gaz

lotsjellës dhe shok-bomba për t'i shpërndarë qytetarët e tubuar para objektit komunal në Zvečan. Protestuesit në Zvečan filluan të shfaqin dhunë, të fyejnë e të hedhin mjete të ndryshme të forta dhe shok-bomba në drejtim të policisë dhe automjeteve zyrtare. Nga tensionet

në veri janë lënduar pesë policë. Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka theksuar se "masat e dhunshme duhet të ndërpritën menjëherë". Ndërkaq institucionet e Kosovës kanë fajësuar "strukturat kriminale dhe ilegale" të Serbisë për përshkallëzimin e situatës

CATHERINE ASHTON RRËFEN PËR VËSHTIRËSITË NË DIALOG DHE NDIKIMIN RUS NË BALLKAN IFAQE 4-5



RENOVA
PUTZ
Maqedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

AKTUALE



BIDENI DHE MCCARTHY BËJNË PËRPARIM PËR TA HEQUR TAVANIN E BORXHIT F.2

OSMANI ME KRYESUESIN E OSBE-së DISKUTOJNË PËR ZHVILLIMET POLITIKE DHE TË SIGURISË NË RAJON F.7

AMBASADA GJERMANE: DO T'U KTHEHEN PARATË ATYRE QË PAGUAN PËR PASAPORTË NË 'VISAMETRIC' NGA 17 MAJI F.7

EKONOMI



HARADINAJ I REAGON QEVERISË PËR AUTOSTRADËN E DUKAGJINIT: AJO DO TË BËHET SAPO TË IKNI NGA PUSHTETI F.8

IKD-ja, QEVERISË: PO RREZIKONI TË DREJTAT E MIJËRA PENSIONISTËVE F.8

SPORT



NË FUNDJAVË ZHVILLOHET XHIROJA E FUNDIT E SUPERLIGËS F.14

Bideni dhe McCarthy bëjnë përparim për ta hequr tavanin e borxhit

WASHINGTON, 26 MAJ - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, u shpreh se ai dhe Kevin McCarthy, republikani kryesor në Kongres, kishin bërë përparim të rëndësishëm drejt marrëveshjes për t'i shkurtuar shpenzimet dhe për ta rritur tavanin e borxhit të qeverisë, i cili aktualisht qëndron në 31.4 trilionë dollarë.

Mosarritja e marrëveshjes për tavanin e borxhit mund të ketë pasoja të rënda për ekonominë amerikane. Sipas Departamentit të Thesarit, qeveria federale mund të përballet me mungesë fondesh për të mbuluar shpenzime të caktuara deri më 1 qershor.

Gjatë mbajtjes së një fjalimi në Shtëpinë e Bardhë, presidenti demokrat u shpreh se republikanët po kërkojnë shkurtime të konsiderueshme që do të bënin që marrja e Sigurimeve Shoqërore të zgjasë më shumë dhe të çojë në një shkurtime të numrit të mësuesve, oficerëve të policisë dhe

agjentëve të patrullës kufitare. "Unë nuk besoj se e gjithë barra duhet të bie mbi amerikanët e klasës së mesme dhe punëtorë. Miqtë republikanë nuk janë të pajtimit", tha Bideni.

Nëse arrihet një marrëveshje, ajo do të përcaktojë udhëzime të përgjithshme për shpenzimet, ndërkohë që ligjvënësit t'i trajtojnë detajet specifike në javët dhe muajt e ardhshëm.

Çdo marrëveshje për ta rritur kufirin duhet të kalojë të dyja dhomat e Kongresit dhe për këtë arsye varet nga mbështetja dypartiake. Republikanët e McCarthy kontrollonin Dhomën e Përfaqësuesve, ndërsa demokratët e Bidenit mbajnë Senatin.

Kjo mund të paraqesë një sfidë, pasi disa republikanë konservatorë dhe demokratë të shumtë progresivë kanë shprehur pakënaqësinë e tyre me idenë e arritjes së një kompromisi.

Falimentimi i ShBA-së mund t'i përmbyesë tregjet financiare



globale dhe ta shtyjë ShBA-në në recesion. Sipas kryetarit të Shefave të Shtabit të Përbashkët, Mark Milley, kjo kërcënon sigurinë kombëtare.

Demokratët dhe republikanët kanë afat deri më 1 qershor për

ta rritur kufirin e vetëhuamarrjes së qeverisë, përndryshe do të rezultojë në një falimentim të paprecedent të borxhit. Ekonomistët paralajmërojnë se mospagimi i borxhit mund të çojë në një recesion.

Një dështim për ta hequr tavanin e borxhit do të shkaktonte një tronditje në tregjet financiare dhe do t'i rriste normat e interesit në çdo gjë, nga pagesat e makinave deri të kartat e kreditit.

Japonia vendos sanksione të reja kundër 80 organizatave të Rusisë



TOKIO, 26 MAJ - Japonia do të vendosë sanksione shtesë ndaj Rusisë pasi samiti i Grupit të Shtatë (G7) që vendi priti javën e kaluar ra dakord për t'i rritur masat për ta ndëshkuar pushtimin e Ukrainës nga Moska, tha të premtën kryesekretari i kabinetit të kryeministrit japonez Hirokazu Matsuno.

Matsuno, zëdhënësi kryesor i qeverisë së Tokios, kritikoi veprimin e fundit të Rusisë për vendosjen e armëve bërthamore taktike në Bjellorusi, duke deklaruar se do ta përshkallëzonte edhe më tej

situatën rreth pushtimit të Ukrainës. "Si i vetmi vend që ka pësuar bombardime bërthamore gjatë kohës së luftës, Japonia nuk e pranon kurrë kërcënimin bërthamor të Rusisë, e lëre më përdorimin e tij", tha Matsuno në një konferencë të rregullt për shtyp.

Udhëheqësit e G7-s, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara, Britaninë, Gjermaninë dhe Francën, javën e kaluar treguan vendosmërinë e tyre për ta mbështetur Ukrainën me ndihma ushtarake shtesë dhe sanksione ndaj Rusisë, në

samitin vjetor të mbajtur në Hiroshimë.

Në një veprim të koordinuar me G7, Japonia do të ngrijë asetet e 78 grupeve dhe 17 individëve, duke përfshirë oficerë të ushtrisë në Rusi dhe do të ndalojë eksportet në 80 entitete ruse, si laboratorët kërkimorë të lidhur me ushtrinë.

Japonia do ta ndalojë edhe ofrimin e shërbimeve të ndërtimit dhe inxhinierisë për Rusinë, megjithëse detajet e masës do të shpallen në një datë tjetër, tha një deklaratë e Ministrisë së Tregtisë.

Arrestohen 37 persona në aksionin kundër një grupi kriminal nga Ballkani

ZAGREB, 26 MAJ - Gjatë një operacioni policor ndërkombëtar, 37 persona u arrestuan si pjesë e një bande kriminale "shumë të dhunshme" nga Ballkani Perëndimor, ka njoftuar Europol.

Aksioni u koordinua nga Kroacia.

Kjo "celulë e fuqishme kriminale" ishte e përfshirë kryesisht në trafikun në shkallë të gjerë të drogës dhe armëve të zjarrit në të gjithë Evropën, tha agjencia e zbatimit të ligjit të Bashkimit Evropian. "Gjatë hetimit u arrestuan gjithsej 37 të

dyshuar, duke përfshirë kreun e bandës, një shtetas të Bosnjë e Hercegovinës, të cilin Europol e konsideron një objektiv me vlerë të lartë dhe që aktualisht po vuan një dënim me katër vjet burg në Itali", tha Europol në një njoftim.

Kreu i bandës dyshohet se organizonte kontrabandën e drogës dhe armëve të zjarrit duke u dhënë urdhra vartësve, edhe pse ishte në qeli, shton Europol. Në të njëjtën kohë, të enjten, një seri bastisjesh u kryen në Kroaci, Slloveni, Bosnjë-Hercegovinë, Holandë, Itali, Belgjikë dhe

Gjermani kundër anëtarëve të dyshuar të bandës.

Së bashku me arrestimet, policia sekuestroi rreth 148 000 euro para të gatshme, 18 armë zjarri, duke përfshirë dy automatikë dhe 500 gramë TNT me detonatorë nga distanca.

Policia ka sekuestruar edhe 15 kilogramë kokainë, 11 kilogramë heroinë, si dhe sasi më të vogla të drogave të tjera.

Hetimi ndërkombëtar pasoi atë që Europol e përshkroi si një "hetim i ndërlikuar" i kryer nga policia kroate si pjesë e Task Forcës "Ballkan Cartel".



QYTETARËT SERBË I PENGUAN KRYETARËT E RINJ TË TRI KOMUNAVE NË VERI, ZVEÇAN,
LEPOSAVIQ DHE ZUBIN POTOK, TË HYJNË NË ZYRA

Situatë e tensionuar në veri, ShBA-ja kërkon të ndërpritet dhuna



Grupe qytetarësh serbë janë përplasur të premtën me Policinë e Kosovës e cila po i ndihmonte kryetarët e rinj të tri komunave të banuara me shumicë serbe në veriun e vendit, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, për të hyrë në zyrat e tyre. Policia e Kosovës përdori gaz lotsjellës dhe shok-bomba për t'i shpërndarë qytetarët e tubuar para objektit komunal në Zveçan. Protestuesit në Zveçan filluan të shfaqin dhunë, të fyejnë e të hedhin mjete të ndryshme të forta dhe shok-bomba në drejtim të policisë dhe automjeteve zyrtare. Nga tensionet në veri janë lënduar pesë policë. Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka theksuar se “masat e dhunshme duhet të ndërpritën menjëherë”. Ndërkaq institucionet e Kosovës kanë fajësuar “strukturat kriminale dhe ilegale” të Serbisë për përshkallëzimin e situatës

të cilët më pas u janë kthyer detyrave policore”, ka njoftuar policia.

Gjithashtu janë shkaktuar dëme materiale ndaj katër automjeteve zyrtare, njëres prej tyre ia kanë vënë zjarrin. “Dyshohet se në afërsi janë dëgjuar edhe të shtëna me armë zjarri, por që ende nuk dihet lokacioni i saktë. Duke parë rrezikun e drejtpërdrejtë të jetës së zyrtarëve policorë, njësitet policore relevante në vetëmbrojtje janë detyruar të reagojnë dhe të përdorin mjetet e ligjshme, përfshirë gazin lotsjellës për shpërndarje të turmës, dhe për t’ua mundësuar hyrjen kryetarëve në objekte komunale. Lidhur me veprimet e deritanishme policia ka bashkëpunuar dhe koordinuar veprimet me organet e drejtësisë, të cilat rastin e kanë cilësuar si ‘Sulm kundër rendit kushtetues’, është theksuar në komunikatën për medie.

Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka theksuar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës i “dënojnë veprimet e vazhdueshme të autoriteteve kosovare për të hyrë në ndërtesat komunale në veri të Kosovës”. “Masat e sotme të dhunshme duhet të ndërpritën menjëherë”, ka shkruar ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, në “Twitter”.

Autoritetet e Kosovës fajësuan “strukturat kriminale dhe ilegale”

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 26 MAJ - Grupe qytetarësh serbë u përplasën të premtën me Policinë e Kosovës e cila po i ndihmonte kryetarët e rinj të tri komunave të banuara me shumicë serbe në veriun e vendit për të hyrë në zyrat e tyre. Policia përdori edhe gazin lotsjellës dhe shok-bomba për t'i shpërndarë qytetarët e tubuar rreth tyre dhe për t'ua mundësuar hyrjen në zyra kryetarëve të rinj.

Në Zveçan u dëgjuan edhe të shtëna armësh, ndërsa në vendngjarje u panë edhe automjete të ndihmës së shpejtë. Duke e parë situatën, qytetarë serbë kanë parkuar në mes të rrugëve në hyrje dhe dalje të Leposaviqit disa kamionë.

Policia e Kosovës ka lëshuar një komunikatë për medie duke treguar më gjerësisht për pengimit të hyrjes së kryetarëve të komunave në vendet e tyre të punës, pranë hyrjeve të objekteve komunale të tri komunave janë tubuar një numër i konsiderueshëm i qytetarëve, për të mos lejuar hyrjen e tyre dhe stafit përcjellës në objektet zyrtare të komunave. Përveç personave të angazhuar dhe automjeteve/mjeteve të tyre të vendosura në afërsi dhe pranë objekteve komunale, në komunat veriore janë lëshuar edhe alarmet të cilat përdoren nga strukturat kriminale për mobilizim dhe tubime. Policia e Kosovës ka angazhuar njësitet relevante policore me qëllim të menaxhimit të situatës dhe

rrethanave të krijuara nga ana e qytetarëve të tubuar të cilët i pengonin organet e rendit dhe zyrtarët shtetërorë në ushtrimin e së drejtës së tyre legjitime”, ka njoftuar Policia e Kosovës, duke shtuar se zyrtarët e rendit publik vazhdimisht kanë biseduar me qytetarët e tubuar, duke kërkuar që të largohen dhe të mos pengohet puna e zyrtarëve shtetërorë, të lirohet rruga dhe të lejohet hyrja e tyre në vendet e punës, mirëpo ata kanë refuzuar vazhdimisht. “Protestuesit në Zveçan pas një kohe kanë filluar të shfaqin dhunë, të fyejnë e të hedhin mjete të ndryshme të forta dhe shok-bomba në drejtim të policisë dhe automjeteve zyrtare, duke shkaktuar rrezik të drejtpërdrejtë dhe lëndime të lehta trupore deri tani ndaj pesë zyrtarëve policorë



të Serbisë për përshkallëzimin e situatës. “Dhuna nuk do të mbizotërojë. Serbia mban përgjegjësi të plotë për përshkallëzimin”, ka shkruar në “Twitter” Blerim Vela, shef i stafit të presidentes Vjosa Osmani. Mediet në Serbi raportuan se presidenti serb Aleksandër Vuçiq nënshkroi një urdhër për ngritjen e gatishmërisë luftarake të ushtrisë së Serbisë në nivelin më të lartë dhe ka urdhëruar lëvizjen e njërive në drejtim të vijës kufitare me Kosovën.



Catherine Ashton rrëfen për vështirësitë në dialog dhe ndikimin rus në Ballkan

Ish-përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme, Catherine Ashton, u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë që të ulen në tavolinën e negociatave dhe të gjejnë përgjigje për mospajtimet e tyre. Ajo ka thënë se e ardhmja e tyre varet nga marrëdhëniet që krijojnë me Bashkimin Evropian dhe marrëdhëniet mes vendeve të rajonit. Në një intervistë me shkrim për “Radion Evropa e Lirë”, Ashton ka reflektuar për kohën sa e ka ndërmjetësuar dialogun mes këtyre dy vendeve dhe se si e vlerëson kontributin e saj në këtë proces. Ajo ka folur për përvojën e saj si diplomate në librin e saj më të ri. “Dhe më pas çka: Rrëfimet e brendshme të diplomacisë së shekullit XIX”

PRISHTINË, 26 MAJ -

Në librin tuaj të ri, “Dhe më pas çka: Rrëfimet e brendshme të diplomacisë së shekullit XIX (And Then What? Inside Stories of 21st-Century Diplomacy)”, ju keni thënë se nuk e keni shijuar pozitën e përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian, por keni pasur edhe momente të mira. Çfarë ka qenë më e vështirë për ju? Karakteristikat e negociatorëve, të cilët i keni ndërmjetësuar, apo situatat, kur secili humb pak, ashtu që të arrihet kompromisi?

Catherine Ashton: Ka qenë e vështirë t'i shoh sfidat me të cilat përballen shumë njerëz për shkak të konfliktit, kaosit apo ndonjë katastrofe. Për secilin që tenton të ndihmojë, ekziston gjithmonë një ndjesi që nuk bën kurrë mjaftueshëm – dhe unë natyrisht jam ndier ashtu. Kënaqësia dhe përmbushja kanë ardhur në momentet kur kam besuar se kam

arritur të bëj dallimin. Nuk ka të bëjë vetëm me humbjen – disi kompromisi është bërë fjalë që nuk e duam. Në negociatë ju kërkoni zgjidhje për problemet, sidomos për ata që kanë probleme. Kompromisi pason mbajtjen e fokusit kah e ardhmja, tentimet për të gjetur se çfarë është më e mira për një komunitet apo një shtet, dhe marrja e vendimit se çka është më e rëndësishme. Negociatorët e mirë punojnë me qetësi dhe vazhdimisht bëjnë përpjekje për të gjetur zgjidhje.

Ju keni luajtur rol të rëndësishëm në arritjen e marrëveshjes në Bruksel më 2013. Megjithatë, deri më sot Kosova dhe Serbia nuk kanë arritur përparim të madh në normalizim të marrëdhënieve. Kë duhet fajësuar?

Catherine Ashton: Secila palë e di se e ardhmja e tyre varet pjesërisht nga marrëdhëniet që i ndërtojnë me Bashkimin Evropian dhe pjesërisht

nga marrëdhëniet që i krijojnë brenda rajonit të tyre. Dhe, kjo nënkupton gjetjen e një rrugë për të krijuar një të ardhme që ofron paqe, siguri dhe sukses ekonomik për të dyja palët. Nuk ka qenë kurrë e lehtë - Marrëveshja e Brukselit ka qenë vetëm fillimi - mirëpo u bëj thirrje të dyja palëve që të ulen në tavolinën dhe të gjejnë përgjigje.

Cila ka qenë pjesa më e vështirë për t'i afruar palët deri te nënshkrimi i Marrëveshjes së Brukselit? Cila ka qenë sfida më e madhe?

Catherine Ashton: Imagjinojeni këtë skenë: Dy kryeministra, në moshë të njëjtë, nga rajoni i njëjtë, që nuk janë takuar kurrë, dhe të cilët bartin shpresat dhe aspiratat e popujve të tyre, të përziera me historinë dhe traumën e së kaluarës. Ka qenë gjë e guximshme vetëm pjesëmarrja në dhomë të njëjtë. Sfidë ka qenë njohja e së kaluarës, humbjet dhe

dhimbjet e shumë personave, si dhe krijimi i një vizioni, për të siguruar që të rinjtë në Kosovë dhe Serbi, mund të shikojnë përpara drejt së ardhmes në BE. Vështirësia më e madhe për liderët është përgatitja për të ecur përpara. Është më e lehtë që të mos bësh asgjë. Fatmirësisht, të dyja palët kanë qenë të përgatitura në atë drejtim.

BE-ja ka leva të rëndësishme dhe shtesa për Kosovën dhe Serbinë që ta zbatojnë marrëveshjen. Ndër më të rëndësishmet, integritet evropian. Megjithatë, duke marrë parasysh dinamikën e zgjerimit të BE-së, kjo gjë duket se nuk ka shërbyer si mjet i fuqishëm. Në çfarë niveli ka dështuar BE-ja që t'i shtyjë të dyja palët që t'i tejkalojnë dallimet dhe të gjejnë gjuhë të përbashkët?

Catherine Ashton: E kuptoj që ekziston shqetësimi në rajon, që BE-ja nuk është entuziaste sa ka qenë dikur për zgjerim. Megjithatë, nuk ka dilema që shtetet e Ballkanit Perëndimor i përkasin BE-së. Përkushtimi i bllokut është i qartë në punën që e bën Miroslav Lajçak, për ta vazhduar punën me Kosovën dhe Serbinë. Por, duhet bërë shumë punë edhe shtetet që duan të jenë pjesë e BE-së. Një arsye për mungesë entuziazmi qëndron te mungesa e përparimit të bërë nga vendet që duan të jenë anëtare. Nuk është një rrugëtim i lehtë, por ia vlen të bëhet.

Në librin tuaj ju sqaroni se jo gjithçka funksionon më së miri nëpër organizatat ndërkombëtare, si BE-ja, NATO-ja dhe Kombet e Bashkuara. Ju keni thënë: “Sa i përket ndërmjetësimit në mes të Kosovës dhe Serbisë, roli i Shteteve të Bashkuara ka qenë i heshtur, në pjesën më të madhe të kohës por, megjithatë, vital. A besoni se ShBA-ja tani ka më shumë fuqi sesa BE-ja, sidomos te Kosova?”

Catherine Ashton: Unë besoj në punën me miq e aleatë dhe në gjetjen e zgjidhjeve. Shtetet e Bashkuara e kanë një lidhje të veçantë me Kosovën, që nënkupton se ato kanë arritur ta rikonfirmojnë mbështetjen e tyre, teksa Kosova ka marrë hapa drejt asaj që njihet si Marrëveshja e Brukselit. Nuk ka të bëjë me atë se kush ka më shumë fuqi - ka të bëjë me fuqinë e të punuarit së bashku.

Si e vlerësoni, në përgjithësi, situatën në Ballkan? Teksa palët, dikur ndërlyftuese, tani promovojnë bashkëpunim, sidomos në fushën e ekonomisë, pothuajse të gjitha çështjet e tjera, shembull, mospajtimet etnike, mbesin të pazgjidhura (në Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë). Në të njëjtën kohë, demokracia në Ballkan po rrezikohet nga korrupsioni i shfrenuar, mosrespektimi i rendit dhe ligjit dhe shtypja e lirisë së medie. Ndonëse

Osmani me kryesuesin e OSBE-së diskutojnë për zhvillimet politike dhe të sigurisë në rajon

PRISHTINË, 26 MAJ - Presidentja Vjosa Osmani ka pritur të premten në takim ministrin e Jashtëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, njëherësh kryesues aktual i OSBE-së. Në takim me ministrin Osmani, presidentja diskutoi për bashkëpunimin e institucioneve të Republikës së Kosovës me OSBE-në përgjatë viteve, raportet bilaterale me Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe për zhvillimet e fundit politike dhe të sigurisë në rajon dhe më gjerë.

Presidentja Osmani u informua mbi prioritetet e ministrit Osmani dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut si kryesues të sivjetmë të OSBE-së, si dhe diskutuan mbi mbështetjen e OSBE-së për Republikën e Kosovës në të kaluarën dhe bashkëpunimin aktual, në veçanti. Osmani ka përmendur vazhdimin e bashkëpunimit për fuqizimin e vazhdeve, grave dhe rinisë, me theks të veçantë në agjendën për gratë, paqen dhe

sigurinë.

Presidentja Osmani ka theksuar se Kosova vazhdon të jetë në ballë të përparimit në rajon dhe më gjerë sa i përket forcimit të sundimit të ligjit dhe demokracisë, si dhe promovimit të të drejtave të njeriut të cilat tanimë po njihen ndërkombëtarisht. Osmani shprehu përkushtimin e institucioneve të Republikës për vazhdim të bashkëpunimit të ngushtë me partnerët e saj për ta avancuar rrugën euroatlantike të vendit tonë i cili mbetet prioritet shtetëror.

Në temën e raporteve bilaterale me Republikën e Maqedonisë së Veriut, presidentja Osmani ka vlerësuar rritjen e bashkëpunimit në mes të dy vendeve tona si dhe përkushtimin e ndërsjellë për thellimin e mëtejshëm të tyre.

Presidentja Osmani dhe ministri i Jashtëm i Maqedonisë së Veriut, Osmani, kanë folur edhe për dialogun me Serbinë, me ç'rast Osmani ka theksuar shkeljet e vazhdueshme të Serbisë karshi



marrëveshjeve të Brukselit, ndërsa ka përmendur angazhimin e Kosovës për paqe dhe stabilitet afatgjatë në rajon.

Kryesuesin e OSBE-së e ka pritur në takim edhe kryeministri Albin Kurti, i cili e ka falënderuar OSBE-në për kontributin e dhënë për

demokratizimin në Kosovë. Bujar Osmani, gjithashtu, është takuar edhe me ministrin e Jashtëm Donika Gërvalla.

Grenelli: Thaçi duhet të lirohet, evropianët po bëjnë një punë të pistë

PRISHTINË, 26 MAJ - Ish-i dërguari i ShBA-së për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, në një intervistë për "Top Story" në "Top Channel", ka kërkuar lirimin e menjëhershëm të Hashim Thaçit. Për plagën që u është shtuar dhimbjeve të luftës së Kosovës, mbajtjen e Thaçit në burg, Grenelli tha se evropianët po bëjnë një punë të pistë. "Kryeministri Rama ka folur shumë hapur për z. Hashim Thaçi dhe çfarë po bëjnë evropianët në Gjykatën e Drejtësisë në Hagë. Ai e ka quajtur Thaçin peng, dhe kjo që po bëjnë evropianët është skandalozë. Duhet të jemi të aftë e të shohim përpara. Duhet ta

lirojnë Thaçin, duhet ta pranojnë se çështja e Jack Smith ishte politike. Evropianët duket sikur po bëjnë një punë të pistë për shkak të politikës", ka thënë Grenelli.

I njohur për qëndrimet e tij kundër Albin Kurtit, Grenelli tha se kryeministri i Kosovës kurrë nuk ka pranuar idetë e amerikanëve. "Çështja është kjo, unë e njoh Albin Kurtin. Shikojini politikën e tij dhe ju sfidoj të gjeni një ide amerikane që ka rënë dakord. Ai ka refuzuar çdo ide, që nga Obama, Klintoni e Xhoxh Bushi, gjithmonë ka qenë kundër", ka deklaruar Grenelli.



BE-ja i ka kritikuar këta trendë në përgjithësi, me raste duket se e mbyll njërin sy, duke besuar se kështu i shtyn liderët autoritarë të Ballkanit që të arrijnë marrëveshje gjeopolitike. Shembull është presidenti serb Aleksandar Vuçiq për çështjen e Kosovës.

Catherine Ashton: BE-ja është e bazuar në parime – demokraci, të drejta të njeriut, sundim të ligjit. Këto janë thelbësore. Duke punuar me shtetet e tjera, ato mbesin pjesë e dialogut të vazhdueshëm.

Në një opinion të vitit 2021 për "Politico"-n, të quajtur "Mos ia mbyllni derën Ballkanit Perëndimor", ju dhe autorë të tjerë thonin se alternativë është regresi drejt një Evrope të ndarë, të rrethuar nga fuqi, që në thelb nuk kanë as interesa, as vlera. "Lënia e Ballkanit Perëndimor në një zonë të



përhershme muzgu, do të përbënte humbje strategjike - dhe të pashmangshme". A mund të bëjë BE-ja më shumë?

Catherine Ashton: Nuk është vetëm roli i BE-së që t'i shtyjë përpara vendet e Ballkanit Perëndimor. Është edhe detyrë e secilit shtet që t'i kryejë të gjitha ndryshimet e nevojshme dhe të merret me të gjitha çështjet e

nevojshme për t'u bërë anëtar i BE-së. Prandaj, shpresoj që do të bëhet më shumë, nga të gjithë, për t'i adresuar këto sfida.

Në vitin e fundit të mandatit, më 2014, Rusia e ka aneksuar Gadishullin e Krimesë. A mendoni se reagimi me kohë do të mund ta parandalonte luftën në Ukrainë, të

nisur në shkurt të vitit 2022? Çfarë ka mundur të bëhet ndryshe?

Catherine Ashton: Ne kemi reaguar atëherë, duke i vënë sanksione Rusisë, dhe duke tentuar të negociojmë. Reflektimi është gjithmonë i vështirë – atëherë nuk kemi ditur atë që e dimë sot. Megjithatë, sipas mendimit tim, në vitet pasuese, ajo që ka ndodhur në Ukrainë, nuk ka qenë në agjendë, aq lart sa do të duhej të ishte.

Deri në çfarë pikë është duke ndikuar Rusia në dialog dhe në situatën në Ballkanin Perëndimor, në krahasim me periudhën kur keni qenë e përfshirë edhe ju?

Catherine Ashton: Ne gjithmonë kemi qenë të vetëdijshëm për ndikimin e Rusisë dhe angazhimin në Ballkanin Perëndimor. Ngjarjet në Ukrainë e kanë vënë më shumë në pah këtë fakt.

Në kohën kur jeni larguar nga Brukseli, nuk është folur, thuajse aspak, për ndikimin kinez. Tani kemi shembuj se si Kina është duke e përhapur ndikimin e saj në Ballkanin Perëndimor përmes borxheve, donacioneve dhe projekteve infrastrukturore. Madje edhe në disa vende të BE-së. Njerëzit nuk e shohin ndikimin kinez si kërcënim, në krahasim me ndikimin rus. A pajtoheni?

Catherine Ashton: Sfida e Kinës është ndryshe prej situatës me Rusinë. Shpresoj se do të shohim më shumë përpjekje për krijimin e një qasjeje strategjike ndaj Kinës, duke përfshirë lidhjet dhe shqetësimet aktuale. Rikujto se Kina ka luajtur rol në negociatat me Iranin, dhe shpresa ime është që Kina të synojë rol pozitiv në sistemin multilateral, për të cilin duhet të kujdesemi.

Vazhdon mbajtja e zgjedhjeve të këshillave lokale në fshatrat e Mitrovicës

MITROVICË, 26 MAJ - Komisioni për zgjedhjen e këshillave lokale po vazhdon procesin e zgjedhjes së kryetarit dhe anëtarëve të këshillave të fshatrave në komunën e Mitrovicës. Kryetar i këshillit të fshatrave Vërrnicë dhe Pirq u

zgjodh Ramadan Rexhepi, ndërsa për fshatin Vidimriq u zgjodh Zymer Behrami. Në fshatin Vërrnicë dhe Pirq u zgjodhën gjithsej 5 anëtarë, kurse në Vidimriq 7 anëtarë. Në këtë proces të zgjedhjeve morën pjesë nënkryetari i komunës, Arian Tahiri dhe

anëtarët e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale, Jeton Ujkani, Majlinda Kurti dhe Valbona Sadiku. Nënkyetari Tahiri tha se ndihet i lumtur që fryma demokratike po përcjell procesin në të gjitha fshatrat.



Në Prishtinë hapet Oda Nordike



PRISHTINË, 26 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në inaugurimin e Odës Nordike, dhomës së re të biznesit nordiko-kosovar.

Kryeministri tha se një nga objektivat kryesore të "NordiKo" do të jetë mbështetja e investitorëve të mundshëm nga vendet nordike për t'i eksploruar mundësitë e investimeve dhe shkëmbimit tregtar për dhe nga Kosova.

Ai ka treguar se kjo dhomë biznesi do të shërbejë si një katalizator për përparimin, një platformë që nxit

bashkëpunimin, inovacionin dhe sipërmarrjen.

Me këtë rast, ai tha se Kosova do të bëhet vendi më konkurrues në Ballkanin Perëndimor kur bëhet fjalë për Investimet e Huaja Direkte. "Madje, për të treguar se sa të rëndësishme i konsiderojmë investimet e huaja direkte dhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi, kryeministri tregoi se jemi në procesin e krijimit të Agjencisë së Investimeve dhe Eksportit në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe po punojmë me disa organizata partnere ndërkombëtare për të zhvilluar

procese efektive, që mundësojnë rritjen e shpejtë e të qëndrueshme të investimeve të huaja dhe të orientuara drejt eksportit", ka thënë Kurti.

Në ceremoninë e hapjes së Odës Nordike, të pranishëm ishin edhe ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ambasadori i Finlandës në Kosovë, Matti Nissinen, ambasadori i Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund, ambasadori i Norvegjisë në Kosovë, Jens Grondahl, si dhe drejtoresha e Bordit, Afërdita Pllana.

Zëvendësministri i Mbrojtjes viziton Aeroportin e Gjakovës, sheh nga afër ushtrimin ndërkombëtar "Defender Europe '23"



GIKOVË, 26 MAJ - Zëvendësministri i Mbrojtjes, Shensi Syla, i shoqëruar nga drejtori i televizionit të RTK-së, Rilind Gërvalla, ka realizuar një

vizitë në Aeroportin e Gjakovës dhe në kampin Devë, me qëllim të njoftimit nga afër me rrjedhën e ushtrimit ndërkombëtar "Defender

Europe '23" si dhe për ta parë punën e institucionit publik, Radio Televizionit të Kosovës (RTK), i cili është duke e mbuluar direkt nga terreni këtë

aktivitet ushtarak. Me këtë rast, zëvendësministri Syla dhe drejtori Gërvalla janë pritur nga zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi dhe

Komandanti i Regjimentit të parë të këmbëtorisë, nënkolonel Albert Kuqi, të cilat njoftuan për mbarëvajtjen e këtij ushtrimi ndërkombëtar.

Filloi deratizimi në Prizren

PRIZREN, 26 MAJ - Në kuadër të realizimit të projektit "Dezisektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i qytetit të Prizrenit", të Drejtorisë së

Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të premtën ka filluar implementimi i fazës së parë të deratizimit të

rrjetit të kanalizimit (largimit të brejtësve) brenda dhe në zonat periferike të qytetit. Realizimi i këtij projekti

është paraparë të zgjasë tri ditë dhe ka qëllim mbrojtjen e shëndetit publik nga sëmundjet infektive transmetuese.



Trafikantë klandestinësh qëllonjë mbi policinë në kufirin Shqipëri - Kosovë

PRISHTINË, 26 MAJ - Gjashtë shtetas të huaj, sirianë dhe algerianë, janë arrestuar në kufirin Shqipëri - Kosovë, pasi kanë qëlluar me armë në drejtim të policisë. Ngjarja është shënuar mbrëmjen e së enjtes.

Policia e Shqipërisë ka njoftuar homologët e Kosovës se një automjet me klandestinë po kalonte kufirin në mënyrë të paligjshme. Ata kanë bërë me dije se trafikantët që po bënin transportimin e klandestineve kanë qëlluar në drejtim të punonjësve të policisë. Asnjë prej efektivëve të

policisë nuk ka pësuar lëndime. "Plumbat përshkuan veshjet e dy efektivëve por, fatmirësisht, nuk janë në rrezik për jetën", thuhet në njoftimin e policisë së Kukësit. Sipas tyre, janë arrestuar pesë shtetas me origjinë siriane dhe 1 algeriane, të moshave nga 20 deri 40 vjeç, ndërsa një tjetër algerian është shpallur në kërkim. Ata akuzohen për veprat penale "Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit", mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim, "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyes

dhe municionit" dhe "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve".

Sipas policisë, ky grup i armatosur organizonte dhe drejtonte veprimtarinë kriminale të kalimit të paligjshëm të emigrantëve nga vendet e treta përmes kufijve të gjelbër, mes Greqisë, Shqipërisë, Kosovës dhe Serbisë.

Operacioni i quajtur "Strukturimi" po vazhdon për gjetjen e armëve të zjarrit të përdorura në këtë rast si dhe për kapjen e shtetasit algerian të shpallur në kërkim.



Ambasada Gjermane: Do t'u kthehen paratë atyre që paguan për pasaportë në 'VisaMetric' nga 17 maji

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 MAJ - Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë ka reaguar lidhur me rastin e "VisaMetric", kompani kjo e cila merrte 30 euro nga qytetarët për shërbimin postar për pasaporta gjatë aplikimit për vizë në këtë ambasadë.

Ambasada Gjermane ka bërë me dije se është në dijeni për arrestimin e drejtorit të qendrës për pranimin e aplikacioneve për viza të "VisaMetric" dhe ka theksuar se me vëmendje po ndjek procesin gjyqësor ndaj tij. "Pasditën e datës 16 maj 2023 ambasada për herë të parë mësoi për vendimin e Gjykatës Komerciale kundër 'VisaMetric', në të njëjtën ditë kur 'VisaMetric' përmes avokatit të saj edhe pranoi vendimin e shkallës së dytë. 'VisaMetric', menjëherë pasi mësoi për aktgjykimin, në konsultim me Ministrinë e Punëve të Jashtme në Berlin dhe Ambasadën Gjermane në Prishtinë, filloi zbatimin e tij. Pas kësaj, dhe që nga dita e nesërme, të gjithë aplikantëve u është dhënë mundësia që në momentin e parashtrimit të kërkesës të zgjedhin mes tërheqjes personale dhe kthimit të pasaportës përmes shërbimit postar me kosto shtesë, si në

procedurën e deritashme. Personat të cilët nga data 17 maj vendosin për tërheqje personale të pasaportës, ndërsa gjatë caktimit të terminit kanë paguar shërbimin postar për kthimin e pasaportës, do të rimburohen. Që nga data 17 maj 2023 opsioni për kthimin e pasaportës me postë nuk është më i detyrueshëm, kur caktoni terminin në mënyrë elektronike. Njoftimin për këtë, 'VisaMetric' e publikoi në mbrëmjen e datës 16 maj në faqen e internetit, thuhet në reagimin për medie. Më tej, Ambasada Gjermane ka theksuar se në kontratën e lidhur në mes të "VisaMetric" dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Gjermanisë, "VisaMetric" obligohet t'i respektojë përcaktimet e Ligjit Federal për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave. "Prandaj, 'VisaMetric' duhet ta operojë infrastrukturën e saj të teknologjisë së informacionit në përputhje me kërkesat e Zyrës Federale për Sigurinë e Informacionit për Administratën Publike dhe mund t'i ruajë të dhënat personale të aplikantëve vetëm në serverë brenda Zonës Ekonomike Evropiane. Të dhënat e regjistruara alfabetike dhe biometrike të



aplikantëve i dërgohen ambasadës në formë të koduar. Këto të dhëna nuk ruhen në pajisjet e shërbyesit të jashtëm 'VisaMetric'. 'VisaMetric' edhe më tej është e obliguar që menjëherë pas dërgimit t'i fshijë të gjitha të dhënat e aplikantëve dhe të sigurojë që për caktimin e terminit të ruhen vetëm emri, të dhënat e kontaktit si dhe numri i

pasaportës deri në momentin kur pasaporta i kthehet aplikuesit, dhe që këto të dhëna më pas të fshihen menjëherë", theksohet në reagimin e Ambasadës Gjermane në Prishtinë.

Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë ka njoftuar se "VisaMetric" është një ndërmarrje e përbashkët e


zotëruar 60 për qind nga kompania turke "iData" dhe 40 për qind nga kompania "Vms Investments Llc" me bazë në Emiratet e Bashkuara Arabe. "Që kur 'VisaMetric' filloi operimin në Kosovë, në shtator të vitit 2022, kompania nuk ka pasur asnjë lidhje me Rusinë", ka njoftuar Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë.

Shpallet konkursi për hartimin e Master Planit për Kompleksin Memorial Adem Jashari në Prekaz

PRISHTINË, 26 MAJ - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka bërë me dije se është shpallur konkursi për hartimin e Master Planit për Kompleksin Memorial Adem Jashari në Prekaz. "Pas angazhimit të komisionit të ekspertëve për hartim të detyrës projektuese, dhe pas miratimit të kushteve,

kritereve dhe procedurave nga Qeveria e Kosovës, kemi shpallur konkursin për hartimin e Master Planit. Ky është ndër proceset dhe projektet më delikate të Republikës sonë, kemi punuar me hapa të sigurt, pa u ngutur, por edhe pa humbur kohë. Nuk do të kursejmë asgjë për të pasur

një kompleks memorial të përmasave botërore, çfarë është edhe figura e Adem Jasharit. Një kompleks memorial që do të rrëfejë dinjitetshëm dhe me standard të arrirë artistik rezistencën e popullit dhe luftën për liri, pavarësi e bashkim", ka thënë ministri Çeku.



Haradinaj i reagon qeverisë për autostradën e Dukagjinit: Ajo do të bëhet sapo të ikni nga pushteti

PRISHTINË, 26 MAJ - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka reaguar pas deklaratës së ministrit të Infrastrukturës, Liburn Aliu, se Dukagjini nuk do të ketë autostradë, por vetëm zgjerim të rrugës.

Haradinaj ka thënë se autostrada e Dukagjinit do të bëhet sapo të ikë pushteti aktual.

Lideri i AAK-së ka thënë se kur ishte vendosur të merrte udhë projekti i autostradës së Dukagjinit si një investim strategjik, meqenëse do ta lidhte pothuaj një të tretën e territorit të Kosovës me pjesën tjetër, pati filluar një fushatë e egër e Vetëvendosjes kundër tij, me arsyetimin se nuk duhej të shpenzoheshin paratë në asfalt. "Autostrada e Dukagjinit nuk u ndërtua sepse qeveria që udhëhiqja unë ishte ndërprerë në mes, kurse qeveria e Vetëvendosjes jo vetëm që nuk hapi projekte të reja infrastrukturore, por i bllokoi edhe ato ekzistuese. Sot kanë mbetur keq e përfaqe

të zezë jo vetëm rruga për Mitrovicë, për Gjilan, për Pejë, për Gjakovë, por edhe projektet e tjera infrastrukturore, duke i zbritur investimet kapitale në kuota qesharake. Sikur kjo të bëhej me qëllim të rritjes së mirëqenies së popullit, në këto dy vjet të një krize globale ekonomike, edhe do ta kishte një derë por, për fat të keq, nuk ka ndodhur as kjo", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Haradinaj ka thënë se sot Kosova e ka mesataren e pagave më të ulët në rajon, pensionet më të ulëta dhe paga minimale më e ulëta në kontinent. "Ndërkohë që tatimi në pronë është rritur dy e trefish, energjia është rritur të paktën dy herë e të mos flasim për rritjen e çmimeve të artikujve elementarë, apo të inflacionit i cili ka qenë më i larti në këto 20 vjet. Sikur të mos u mjaftonte kjo, qeveritarët e rinj u janë turrur edhe mjetëve vetjake të komunave dhe duan t'i marrin edhe ato! Ose kanë fytyrë e deklarojnë se do të ketë arnime



e zgjerime dhe prapë lidhen tek autostrada e Dukagjinit dhe thonë se ajo nuk do të ndërtohet. E unë e kam një porosi për ta. Po, autostrada e Dukagjinit do të ndërtohet sapo ju të ikni nga pushteti. Shpresoj shumë shpejt!", ka deklaruar Haradinaj.

Një ditë më parë ministri i Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka

thënë se nuk do të ketë autostradë të Dukagjinit. Në një paraqitje për "Tëvë1", Aliu shtoi se janë duke punuar intensivisht, ndërsa sërish shfrytëzoi rastin të gjejë arsye të mungesat e problemet e vitit paraprak. "Tash jemi duke punuar intensivisht, mungesat, problemet e vitit 2022, janë duke u rikuperuar, dhe besoj se

kjo është situata. Nuk mund të bëjmë më tepër për pjesën e Dukagjinit, përpos që kemi filluar projektin e zgjerimit të rrugës nga Istogu dhe, përpos që mund ta bëjmë rrugën e Pejës, që të punojmë për pjesën e Gjakovës. Nuk do të ketë autostradë. Do të ketë zgjerim të rrugës", ka theksuar Aliu.

IKD-ja, qeverisë: Po rrezikoni të drejtat e mijëra pensionistëve

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka theksuar se qeveria në kundërshtim me afatet e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese ka vendosur për Projektligjin për Skemat Pensionale, duke rrezikuar të drejtat e mijëra pensionistëve

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 MAJ - Në dhjetor të vitit të kaluar Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar paragrafin 2 të nenit 8 të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale, sepse në mënyrë diskriminuese përmes këtij neni mijëra qytetarë, duke mos e përmbushur kriterin e përvojës prej 15 vjetëve punë para janarit të vitit 1999, nuk e kanë gëzuar pensionin kontributdhënës, por vetëm atë të moshës.

Gjykata ka urdhëruar Kuvendin dhe Qeverinë që jo më larg se data 15 korrik 2023 t'i ndërmarrin veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji.

Në të njëjtën kohë, këto dispozita do të shfuqizohen më 15 korrik 2023.

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka theksuar se në rastin kur qeveria nuk respekton këtë

datë, do të jenë qytetarët ata që do të pësojnë më së shumti. "Ata do të detyrohen të paguajnë avokatë për të ngritur padi në gjykatat themelore për ta gëzuar të drejtën e pensionit kontributdhënës sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Për shkak se do të gjenerohen shpenzime procedurale, kjo situatë mund ta dëmtojë edhe buxhetin e Republikës së Kosovës", theksohet në reagimin e IKD-së. Por, qeveria ka planifikuar që projektligjin që synon t'i adresojë kërkesat e Gjykatës Kushtetuese vetëm në qeveri, ta miratojë më 30 korrik 2023. Sipas IKD-së, afati i përcaktuar nga qeveria është në kundërshtim me kërkesat e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese. "Në sistemin kushtetues të Kosovës aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese janë ekuivalente me normën kushtetuese. Ky



veprim i qeverisë është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Veprimet e nevojshme për adresimin e kërkesave në bazë të aktgjykimit nënkuptojnë hyrjen në fuqi të projektligjit të ri për skemat pensionale më 15 korrik 2023 dhe jo miratimin e projektligjit në qeveri me 15 ditë vonësë. Duke pasur parasysh që edhe Kuvendi i Kosovës shkon në pushim në fund të muajit korrik dhe fillimi i punës së Kuvendit nis të hënën e dytë të muajit

shtator, atëherë miratimi final i projektligjit do të bëhet me vonësë prej disa muajve", thuhet në reagimin e IKD-së. IKD shpreh shqetësimin e thellë për papërgjegjshmërinë e Qeverisë së Kosovës në lidhje me moszbatimin e kërkesave të plota që dalin nga Aktgjykimi në rastin nr. KO190/19. "Vonesat në miratimin e këtij projektligji nga qeveria shkelin të drejtat e mijëra pensionistëve të Kosovës dhe paraqesin moszbatim të aktgjykimit të

Gjykatës Kushtetuese. IKD kërkon që me rastin e miratimit të projektligjit në qeveri të respektohen standardet minimale të pjesëmarrjes së publikut në konsultime publike me qytetarë dhe grupeve të interesit dhe më pas një projektligji i tillë të miratohet me procedurë të përshpejtuar në Kuvendin e Kosovës në mënyrë që ky ligj të hyjë në fuqi jo më vonë se data 15 korrik 2023", është theksuar në këtë reagim.

'Luanët e tastierës', si shpjegohet agresioni që fshihet pas një ekrani



Nga Elena BERNABÈ

"Urrejtësit e mëdhenj synojnë veten e tyre. Ata sëmuren nga urrejtja. I drejtojnë armën dikujt, që të mos ia drejtojnë atë vetes"

Edoardo Albinati, Kronikë e një mendimi famëkeq, 2018

Quhen "luanët e tastierës", dhe këtu përfshihen të gjithë njerëzit që kanë një qëndrim fyes ndaj përdoruesve të tjerë apo lajmeve në rrjet. Në realitet, të gjithëve na ndodh të jemi "luanët e tastierës" kur veprojmë në mënyrë agresive, polemike ose ofenduese, në telefon ose kompjuter, në dhomat e bisedave, në mediat sociale apo duke komentuar lajmet e gazetave. Ekranin heq të gjitha kufizimet dhe frenimet, dhe fjalitë që ne nuk jemi në gjendje t'i shqiptojmë drejtpërdrejt, shkruhen dhe publikohen lehtësisht duke lënduar të tjerët, duke krijuar pakënaqësi, duke krijuar hapësirë për dinamika sociale shkatërruese. Kjo fshehje pas telefonave dhe kompjuterëve e lejon agresionin tonë më primitiv (dhe rrjedhimisht shkatërrues) të veprojë i patrazuar dhe të shkaktojë dëme të mëdha. Dhe kjo vlen si për të rriturit ashtu edhe për fëmijët, të cilët hyjnë në këtë botë virtuale pa mbrojtjen e

duhur për të përballuar situatën. Si gjithmonë e kemi kaluar kufirin përtej të cilit teknologjia kthehet nga konstruktive në shkatërruese. Tastiera dhe rrjetet sociale po i privojnë qeniet njerëzore nga humanizmi, dhe të zbrazësh në rrjetet sociale gjykimet burracake dhe të vrazhda është më e lehtë se kurrë më parë.

Është një lloj si të hedhësh gurin dhe të fshehësh dorën, të shtireni sikur jeni si baballarë të mirë dhe profesionistë pa asnjë të metë, dhe më pas të shndërroheni në mbjellës të ligësisë në internet. Është e lehtë të kritikosh, të gjykos, të shprehësh pakënaqësinë tënde, sidomos nëse nuk ke një përballje të drejtpërdrejtë personale.

Nga ky këndvështrim, interneti është kthyer në një kontejner të madh për ankesa, kritika, komente të shkruara me nxitim dhe në mënyrë shumë sipërfaqësore. Mjerisht edhe shumë gazetarë po shkruajnë në këtë mënyrë. Cilido që e lë veten të ndikohet dhe të mbingarkohet nga kjo botë virtuale përballat me rreziqe të mëdha: shëndetësore, emocionale dhe të mirëqenies në përgjithësi.

Në fakt, ne jemi gjithnjë e më shumë të detyruar të përballemi me këtë mënyrë komunikimi (për shembull për punën) dhe në rast se nuk jemi të vetëdijshëm se si e

përdorim teknologjinë, rrezikojmë të bëhemi skllëvër të saj. Ndaj duhet të përpiqemi të mbrojmë veten dhe veçanërisht fëmijët nga ky përdorim jo i shëndetshëm i mjeteve të komunikimit.

"Luanët e tastierës" vetëm sa nxjerrin në pah një mekanizëm relacional jofunksional që konsiderohet normal në ditët e sotme: kërkimi i ndërmetësimit të një makinerie për të bashkëvepruar me një qenie tjetër njerëzore, nuk është një evolucion. Teknologjia mund të na ndihmojë me një shkëmbim të thjeshtë informacioni, mund të shpejtojë burokracinë, të lehtësojë jetën e përditshme, por s'mund të zëvendësojë marrëdhëniet njerëzore! Prandaj duhet të jemi në gjendje ta transformojmë atë në një mbështetje të mirë për marrëdhënien tonë sociale, dhe duhet ta edukojmë veten dhe gjeneratat e reja për një përdorim të shëndetshëm të mjeteve teknologjike të komunikimit. Deri atëherë nuk do duhet të lidhemi përmes tastierës (pra një marrëdhënie e thellë dhe pasurimin e shkëmbimit ndërmjet individualiteteve). Ajo që lipset është një kulturë civilizuese online, që mëson në shkollë respektin për të tjerët dhe ndaj dinjitetit të njerëzve që jetojnë në anën tjetër të tastierës. Një lloj edukimi qytetar

2.0 i cili aktualisht mungon shumë.

Po si mund të zbuten "luanët e tastierës"?

Siç e përmenda që në fillim, "luanët e tastierës" jemi të gjithë ne sa herë që shkruajmë polemika, kritika, ofendime, fyerje në rrjetet sociale ose në bisedat në grup. Kur ndjejmë dëshirën e papërmbajtshme për ta thënë mendimin tonë me arrogancë, për t'i mbyllur gojën atij tjetrit, për të thënë në mënyrë brutale se çfarë nuk shkon.

Është disi e njëjta gjë kur zemërohemi dhe duam që të thyejmë gjithçka që ndodhet rreth nesh për të shfryrë dufin. Është nevoja për reaguar menjëherë për të shprehur emocionet tona. Por nëse do të përpiqemi të qëndrojmë të qetë, në heshtje dhe të presim që emocioni të ndjekë rrjedhën e tij, do të kuptojmë se ajo që kemi dashur të bëjmë, të themi apo të shkruajmë nuk është më aq e rëndësishme.

Sepse mendimet tona kanë marrë një formë tjetër, në krahasim me pak kohë më parë. Zemërimi ka kaluar, duke i lënë vendin një reflektimi të brendshëm që i ka kuptuar si duhet gjërat, dhe që ka zgjedhur rrugë të reja. Gjithçka është më e qartë, dhe dëshira jonë e madhe për të shkruar atë që

patëm ndërmend me siguri që nuk do të kishte ndihmuar.

Kur ndodh diçka që na bezdis, rruga më konstruktive që duhet ndjekur është të mbetemi vetvetja, të dëgjojmë mendimet tona, të mos ua zbulojmë ato të tjerëve para kohe. Përkundrazi duhet t'i bëjmë me dije vetëm pasi t'i kemi përpunuar si duhet. Problemi është se ne nuk jemi mësuar të ndalemi: preferojmë që të veprojmë, me çfarëdo lloji veprimi. "Interneti ka krijuar forma të reja marrëdhëniesh. Njerëzit janë bërë më narcisistë. Interneti ofron mundësinë për ta vënë veten në qendër të vëmendjes, dhe madje edhe për të marrë pjesë aktive në fushata shpifëse kundër të tjerëve. Ky lloj narcisizmi, dikur një lloj domeni vetëm i fisnikëve dhe i të plotfuqishmëve, është përhapur me internetin shumë shpejt dhe në mbarë botën. Me arrogancën e individit, i cili ndihet unik dhe i fuqishëm falë rrjetit, shoqëria e rrjetëzuar është bërë çnjerëzore".

Reinhold Messner, Jeta sipas meje, 2014

Në këtë pikë duhet të pyesim veten: Çfarë marrëdhëniesh duam të krijojmë? Dhe pastaj rruga që duhet të ndjekim do të bëhet shumë e qartë. / "Eticamente" – Bota.al

Si mund ta ndryshojë Al-ja kompjuterin, kulturën dhe rrjedhën e historisë

Nga: Kastriot DERVISHI

Hasan Prishtina u vra nga Ibrahim Çelos (Selo) më 13 gusht 1933 në Selanik. Pasi u arrestua dhe hetua, vrasësi u gjykuar më 24-25 shkurt 1934. I pandehuri pohoi se vrasjen e bëri për të parandaluar shkatërrimin e Shqipërisë që Hasan Prishtina po përgatiste, duke qenë në kontakt me komitetin serbo-bullgar, duke urdhëruar kundrejt shumave të mëdha vrasjen e Ahmet Zogut dhe personaliteteve të tjera të Shqipërisë. Çelo deklaroi se ishte porositur nga Hasani, sepse ishte ordinancë dhe truproje e tij, të përfshihej në vrasjen e planifikuar kundër Ahmet Zogut. Çelo tha se ishin duke ecur në Selanik kur mori një propozim të tillë, të cilin e kundërshtoi dhe e vrau Hasenin. Vëç këtij varianti, tha Çelo, gjykata greke nga ana e saj ngrinte edhe këto dy versione: – H. Prishtina kishte dorëzuar një memorandum në Lidhjen e Kombeve dhe kishte kërkuar ndërhyrje për çlirimin e pakicës shqiptare në Jugosllavi. – Hakmarrje për arsye financiare, sepse për tetë vjet Çelo kish qenë truproje e H. Prishtinës dhe ky i fundit i kishte ndërprerë pagat që i takonin. Gjykata greke vlerësoi më shumë këtë të fundit si shkakun më të mundshëm të ngjarjes, duke artikuluar fjalinë se “ka pasur diferenca financiare mes

atë “e kish dërguar Ahmet Zogu dhe shqiptarët e krishterë e të pabesë” për t’i vrarë djalin. Kryetari e pyeti nëse i pandehuri ishte truproja i Hasanit, por ajo u përgjigj se nuk e dinte. Vjoi dëshminë Omer Prishtina, vëllai i viktimës, ka deklaroi se njihnte të pandehurin dhe se e dinte se ishte dërguar nga Ahmet Zogu. Madje, pretendonte se Zogu kish dërguar njerëz në Vjenë për të vrarë H. Prishtinën. Omeri mohonte që Hasani të kish lidhje me atentatin ndaj Ahmet Zogut në Vjenë në vitin 1931. Omeri pranonte faktin se Çelo i kish kërkuar H. Prishtinën para një muaji rrogat e tij, por ky nuk ia kishte dhënë. Kohë më parë, H. Prishtina i kish dërguar Çelos 100-200 dollarë.

I pandehuri Ibrahim Çelo dëshmoi se Hasan Prishtina e kishte pajisur me një revole për të vrarë Ahmet Zogun, por ai me këtë revole vrau atë (H. Prishtinën).

Deklarata e Ibrahim Çelos para gjykatës dhe revolta e nënës së Hasan Prishtinës

Nga proces citoj dëshmitë e këtyre dëshmitarëve:

-Akileas Pangos deklaroi se vrasësi ekzekutoi Hasan Prishtinën me dy të shtëna në tëmth. Policia arrestoi autorin 150 metra larg vendit të krimit. Një turmë njerëzish që ndodheshin në



Ibrahim Çelo në sallën e gjyqit (foto e botuar në shtypin grek)

kishte ardhur nga Shqipëria për të kryer vrasjen për para dhe konfirmoi se Hasan Prishtina ishte pronar i shkollës “Konstantinidis”.

Ibrahim Çelo deklaroi: “Koka ime është në duart tuaja. Do ta them të vërtetën. Dy vjet e gjysmë më parë takova viktimën në Nice të Francës. Atje nuk kishte të holla dhe më dha disa diamante për t’i lënë peng. I lashë peng dhe i solla 5 000 franga. Pastaj Hasan beu shkoi në Turqi. Unë shkova në Serbi dhe përsëri u ktheva në Francë; atje mora një letër nga H. Prishtina që shkruante se biznesi i tij nuk po shkon mirë. Ai do të vinte në Selanik dhe do të më siguronte një punë për 8 000 franga në muaj. Në atë kohë H. Prishtina ishte në Bullgari dhe pavarësisht letrave që i dërgoja herë pas here ai nuk më përgjigjej. Më në fund, nga Budapesti më dërgoi një letër ku justifikonte heshtjen e tij. Në fund tha se do vinte këtu dhe do takoheshim dhe çdo herë kërkoj të mblidhte 10 komitaxhi bullgarë me të cilët do vrisnin Ahmet Zogun dhe se si shpërblim do t’i jepte 10 mijë franga. Për shkak se hezitova, Prishtina u përpoq të më bindte me një mijë argumente, derisa atë ditë ai humbi durimi dhe në inat e sipër më tha në do ta bëja këtë apo jo këtë vrasje. Kisha frikë se do të nxirrte pistoletën dhe do të më vriste. Kështu që e nxora unë timen dhe e vra. Unë e vra për vendin tim asgjë tjetër. Hasan Prishtina ishte autori moral i atentatit kundër Ahmet Zogut në Vjenë. Unë kam 20 vjet refugjat, por ai donte të na shkatërronte akoma më shumë. Askush nuk më detyroi të vras Hasan Prishtinën. Nëse po gënjej, më varni”. Në atë çast nëna e Hasan Prishtinës po bërtiste duke kërkuar ta varnin në litar Çelon, por ky deklaroi se nuk pendohej për vrasjen që kreu se me këtë veprim “shpëtoi atdheun nga katastrofa”. Avokatët mbrojtës të familjes Prishtina thanë se vrasja ishte vetëm e motivuar politikisht.



Raportimi në një gazete greke për gjyqin ndaj Çelos

Dënimi me burgim të përjetshëm i vrasësit të Hasan Prishtinës

Në gjyq prokurori tha se Prishtina kishte një jetë politike private të pastër dhe ishte një personalitet i respektuar, se shteti grek nuk ishte i përfshirë në vrasje, se policia arrestoi autorin dhe ia dha drejtësisë; se gjatë gjithë kohës që H. Prishtina kishte qenë deputet i Parlamentit Osman, mbante marrëdhënie miqësore me deputetët grekë dhe u shërbente interesave greke; se në valixhen e Hasan Prishtinës ishte gjetur testamenti i tij, sipas të cilit viktimë ka lënë të gjithë pasurinë e tij në favor të institucioneve bamirëse shqiptare. Në fund theksoi se bëhej fjalë për një rast klasik të vrasjes ordinere dhe kërkoj nga trupi gjykues të dënonte të pandehurin sipas aktakuzës. Sipas prokurorit, teza vrasja ishte kryer për arsye financiare dukej krejtësisht e papranueshëm pas, i nëse kjo do të ndodhte, ai do ta kishte vrarë diku tjetër në një vend më të sigurt.

Avokatët e padisë civile (të familjes së H. Prishtinës) theksuan se kjo ishte një vrasje me paramendim dhe kërkuan dënimin e Çelos. Sipas vendimit të gjykatës, nuk u vërtetua asnjë provë për vrasje me paramendim. Anëtarët e gjykatës shprehën mendim të kundërt, një pjesë duke theksuar se ishte një krim ordinere, ndërsa të tjerët mbrojtën mendimin se i pandehuri vrau Hasan Prishtinën sepse e donte shumë vendin e tij dhe i vrari kishte si qëllim të shkaktonte trazira në Shqipëri. Avokatët mbrojtës i kërkuan gjykatës që të vendoste se vrasja ishte kryer në kushtet e vetëmbrojtjes, por gjykata nuk e pranoi këtë. Në aktgjykim shprehej se Ibrahim Çelo me paramendim dhe qëllimisht vendosi dhe ekzekutoi viktimën, dhe përdori një pistoletë me plumba, duke shtuar se i akuzuari u ndodh në tronditje mendore. Prokurori propozoi dënimin e të pandehurit me burgim të

përrjetshëm dhe një dënim të ngjashëm për armëmbajtje pa leje. Ibrahim Çelo u dënua me burgim të përjetshëm për veprën kryesore të vrasjes dhe pesë muaj burg për armëmbajtje. Në fjalën e fundit, Çelo falënderoi gjykatën dhe theksoi se u gjend në një vend të qytetëruar dhe thirr: “Rroftë mbreti! Rroftë atdheu, rroftë kombi!”.

Intervista e Ibrahim Çelos pas dënimit për gazetën “Maqedonia e re”

“Asgjë nuk më ndante nga H. Prishtina. E vlerësoja kontributin e tij deri në momentin kur për të kënaqur ambiciet e tij personale nuk hezitoi të sugjeronte që të vrisja mbretin tonë Ahmet Zogu. Fillimisht mendova se po e thoshte këtë për të më provokuar, por kur e përsëriti, i theksova se jo vetëm që nuk do të bëja asnjë veprim të tillë antipatriotik, por do të reagoja me çdo sakrificë. Që atëherë marrëdhënia jonë u ftoh. Kur i kërkoja para për t’u larguar, ai nuk pranoi dhe më siguroi se do të më jepte para vetëm nëse do t’i jepja besën, domethënë nëse do të vrisja Zogun. Ai bënte shantazhe të hapura. Më kishte nervozuar. Ndaj aritëm këtu, ai në varr dhe unë të kalbëm burgjeve. I jam mirënjohës drejtësisë së vendit tuaj që njohu qoftë edhe pjesërisht gjendjen e vështirë në të cilën më kishte futur Hasan Prishtina”.




Kufoma e Hasan Prishtinës, pas vrasjes

tyre”. Prokurori e karakterizoi veprimin e Çelos si “një natyrë kriminale të aftë për të kryer një krim të rëndë hakmarrjeje”. Çelo deklaroi para gjykatës se banonte në Nice të Francës, ku punonte si pemëshitës, shumë gjuhë të huaja dhe se erdhi në Selanik një muaj para vrasjes. Gjykata thirr si dëshmitarë nënën e H. Prishtinës, 80 vjeçe, e cila tha se e njihnte akuzuarin dhe tha se

vendin e vrasjes e linçuan vrasësin, por ai u largua. – Sabri Koka dëshmoi se Hasan Prishtina bashkëpunonte me deputetët grekë dhe se ishte njeri i mirë; se shkolla “Konstantinidis” ishte pronë e Hasan Prishtinës. – Pronari i hotelit “Astoria” ku qëndronte H. Prishtina, deklaroi se kish parë të ishin takuar 6-7 herë vrasësi me Hasan Prishtinën. – Hasan beu, kushëriri i parë i viktimës, dëshmoi se vrasësi



Ibrahim Çelo



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Portieri i Kosovës, Visar Bekaj pezullohet për 12 muaj

PRISHTINË, 26 MAJ - Visar Bekaj është dënuar me pezullim prej 12 muajve nga Komisioni i Disiplinës dhe Etikës i Federatës Shqiptare të Futbollit (FShF). Sipas këtij komisioni, portieri i Kosovës është dënuar për nxitje të urrejtjes dhe akteve të dhunës. Bekaj gjithashtu është gjobitur edhe me 100 mijë lekë. "Lojtari i KF Tirana, Visar Bekaj, për nxitje të urrejtjes dhe akteve të dhunës, në bazë të nenit 51/1 të KDS, dënohet me 12 (dymbëdhjetë) muaj pezullim nga të gjitha aktivitetet dhe gjobë në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë", thuhet në njoftimin e lëshuar nga FShF-ja. Ky vendim vije një ditë pas

incidenteve të ndodhura në ndeshjen e javës së 35-të në Kategorinë Superiore, mes Tiranës dhe Bylisit, që u mbyll baras 2:2. Kjo ndeshje u përcoll gjithashtu edhe me polemika të ndryshme. Pas përfundimit të ndeshjes, tifozët e Tiranës u futën në fushë dhe e sulmuan gjyqtarin e ndeshjes, ndërsa Bekaj nuk është përmbajtur në një deklaratë televizive. Përveç reprezentuesit kosovar, masa u morën edhe ndaj disa futbollistëve tjerë. Ndaj KF Tiranës është marrë një masë e përkohshme që ndeshjet në shtëpi t'i luajë pa shikues në një afat prej 90-të ditësh.



Në fundjavë zhvillohet xhiroja e fundit e Superligës



PRISHTINË, 26 MAJ - Këtë të diel përfundon edicioni i sivjetmë i Superligës së Kosovës në futboll. Një xhiro para fundit, kampioni i këtij edicioni e skuadrat që do të dalin në garat evropiane dihen, së bashku me Drenicën që bie nga liga. Krejt çka ka mbetur të përcaktohet këtë javë është ekipi i dytë që bie nga liga dhe kush shkon në barazh. Vëmendja do të jetë te Ferizaj e Trepça '89. Ferizajasi qëndrojnë më mirë në këtë aspekt, janë të tetit dhe kanë një pikë më shumë se '89-shi i parafundit. Të dy ekipet i presin duele tejet të forta këtë të diel. Dukagjini e Prishtina do të jenë rivalët e tyre, të cilët po luftojnë

dhëmbë për dhëmbë për vendin e katërt, që mund ta sigurojë Evropën. Ferizaj në terrenin e vet e pret Dukagjinin, që i ka tri fitore radhazi, derisa ata në tri sfidat e fundit kanë një barazim, një fitore dhe një humbje. Në duelet direkte, dy i kanë takuar Dukagjinin e një ka përfunduar pa fitues. Në krahun tjetër, Trepça '89 e pret Prishtinën, një rivale të vjetër. Në pesë sfidat e fundit kryeqytetasit kanë katër barazime e një fitore, ndërsa '89-shi një fitore e tri humbje. Në takimet direkte, dy i ka fituar Prishtina e një është mbyllur baras. Tashmë Ballkani është kampion, trofe të cilin e siguroi javën e kaluar,

pas fitores dhe humbjes së Dritës. Suharekasi këtë javë luajnë ndaj Gjilanit dhe do ta ngrehin trofeun. Të kuqtë nga Gjilani do të jenë në garat evropiane, po ashtu janë edhe në finale të Kupës. Ekipi i dytë sivjet do të jetë Drita, e cila i shkon Drenicës, tashmë të rënë nga liga, për herë të parë në histori të klubit. Përballja e fundit është Malisheva - Llapi. Të dyja ekipet kanë nga 43 pikë dhe kjo përballje do të vendoset se cila do të jetë më përpara njëra-tjetrës. Të gjitha përballjet e xhiros së 36 e të fundit do të luhen nesër (e diel) me fillim nga ora 15:00.

Kurti priti në takim kampionin e superligës në basketboll, Klubin e Basketbollit Peja

PRISHTINË, 26 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur në takim kampionët e këtij edicioni të Superligës së basketbollit në Kosovë, Klubin e Basketbollit Peja. Në ambientin e zyrës së tij, kryeministri vuri theksin te fakti se edicioni i sivjetmë i Superligës ka rikthyer basketbollin në vëmendjen e secilit prej nesh, duke potencuar kështu se rritja e shikueshmërisë dhe mbështetjes për sportin lokal, sinjalizon drejtimin e duhur të zhvillimit të sportit në nivel

shtetëror. Ai i uroi drejtuesit dhe lojtarët e Klubit të Basketbollit Peja për arritjen në këtë sezon dhe u dëshiroi edhe më shumë suksese në të ardhmen. Po ashtu, theksoi se si qeveri jemi të interesuar ta forcojmë sa më shumë sportin, i cila ka shumë rëndësi për rininë dhe për shëndetin, por edhe për afirmimin e shtetit. Në takim, kryeministri Kurti ishte i shoqëruar nga ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi dhe zëvendësministrja e Kulturës,

Rinisë dhe Sportit, Daulina Osmani. Ndërkaq, përveç lojtarëve të KB Peja, të pranishëm ishin edhe drejtuesit e këtij klubi, presidenti Fatmir Gashi dhe zëvendës-presidenti Egzon Burri. KB Peja, e cila shënoi 30-vjetorin e themelimit, ka rrugëtim të gjatë të sukseseve në basketbollin vendor. Ishte edicioni 1992/1993 kur Peja fitoi titullin e parë të kampionit, ndërsa 2022/2023 e bën atë shtatë herë kampion të Kosovës.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Mirlinda Fetahu nga Prishtina, shpall të pavlefshme dëftesat, certifikatën e notave dhe diplomën e lëshuar nga shkolla e mesme Sh.M.T.H.T "7 Shatori", Prishtinë.

- Albin Ahmeti shpall te pavlefshme dëftesat 6 deri 9 te shkollës fillore "Migjeni".

- Besmir Haxhikadrija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl.I,II,III,IV dhe diplomën e shm.m. Ekonomike " Kadri Kusari. Gjakovë.

- Myrvete Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Mjekësisë " Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Nexhat Xhemaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Fadil Hisari " Prizren.

- Gentiana Gashi shpall te pavlefshme dëftesat , certifikatën , diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Andi Haxhiu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Sadri Berisha nga Lipoveci KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. Shaban Gola" nga kl. I-V dhe VI-IX Lipovec.

- Alban Miftari nga Gjkova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Vildane Braha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Tekstil.

- Astrit Duraku shpall të pavlefshme dëftesat, diplomën si dhe certifikatën e maturës të shkollës "Hoxhë Kadri Prishtina" Prishtinë.

- N.T.SH "FIBELLO" Shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 810558330.

- N.T.SH "FIBELLO" shpall te pavlefshme certifikatën e TVSH-SE me numër 330217564.

- N.T.SH" FIBELLO" shpall te pavlefshme certifikatën e numrit fiskal me numër "600694732.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

